



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 26 Korrik 2021

Nr: 107

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 60, TË PARAQITUR NË KQZ NË
DATËN 22.07.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - Kryesues
Elvin LAKO - Anëtar
Ilirjan RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.60, të depozituar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 424, datë 12.07.2021, ‘Për shqyrtimin administrative të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Tiranë”

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Rrethanat e çështjes:

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” denoncimi me nr. 2368 ID të gjeneruar nga sistemi ndaj kandidatëve për deputetë të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë. Denoncuesi pretendon se në shkëlqje të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, zj. Skëndo, ditën e enjte në datë 18 Mars, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës, “Misto Treska”, ka zhvilluar takim me mbështetësit në prani të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj. Gjithashtu në datën 11 Mars në ambientet e të njëjtës bibliotekë, kandidati Alqi Bllako, zhvilloi takim me mbështetësit e Partisë Socialiste. Në cilësinë e provës Organizata “Qëndresa Qytetare” ka vendosur në dispozicion dy link-e të rrjetit social “Facebook” në të cilin sipas saj, gjenden provat e këtij aktiviteti.
Linku: <https://ëëë.facebook.com/ErionVeliaj/videos/475327973499543>
Linku: <https://ëëë.facebook.com/alqibllako/photos/pcb.249855103500745/249854930167429/>
2. Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3503 prot., datë 09.04.2021, i ka kërkuar, Bashkisë Tiranë informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtyre aktiviteteve, të kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës.
3. Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 14.05.2021, administruar me tonën me nr. 5371 prot., datë 19.05.2021, Administratorja e njësisë administrative nr. 10, zj. Karolina Kostallari, bën me dije se në bibliotekën “Misto Treska”, e cila ndodhet në administrimin e kësaj njësie, zhvillon shpesh evenimente dhe aktivitete të karakterit social, kulturor dhe informues për banorët e Njësisë dhe më gjerë, por në asnjë rast nën menaxhimin dhe monitorimin e tyre nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i karakterit zgjedhor, kjo dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, Nr. 35, dt. 29.03.2018 “Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunksionale”.
4. Në përfundim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku paraqitur nga palët si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, çmon se pretendimi i kallëzuesit, Organizata “Qëndresa Qytetare”, për shkëlqje të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet vendosjes së aseteve publike në dispozicion të kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako, është i pabazuar në prova dhe fakte, për këto arsye, me vendimin nr. 424, datë 12.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Bashkisë Tiranë, për arsye se nuk



konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

5. Në datën 22.07.2021, Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 424, datë 12.07.2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organi kompetent për të shqyrtuar kallëzimet e paraqitura nga personat fizikë/juridikë, sipas pikës 2 të nenit 9 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Lidhur me ankesën në fjalë të paraqitur nga organizata “Qëndresa Qytetare”, me vendimin nr. 424, datë 12.07.2021, KSHZ ka vlerësuar se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij dhe referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KSHZ ka çmuar se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qëndresa Qytetare”, përbënin indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

2. Përsa më sipër, KSHZ ka nisur hetimin administrativ për të arritur në përfundimin nëse kemi shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Për nevoja të hetimit, KSHZ është mjaftuar vetëm me kërkimin zyrtarisht informacion lidhur me ngjarjen tek Administratori i Njësisë Administrative nr. 10, Tiranë, me qëllimin për të marrë më shumë sqarime lidhur me zhvillimin e aktivitetit të pretenduar nga subjekti ankues, por siç rezultoi nga provat e administruara edhe nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), ka një paqartësi në interpretimin nga ana e KSHZ të përgjigjes së dhënë nga Administratori në fjalë.
3. KAS, pasi mori edhe konfirmimin nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), konstaton se në procedurën e shqyrtimit administrativ të ndjekur nga KSHZ, nuk ishin thirrur si palë për të patur në këtë mënyrë mundësi të shprehnin qëndrimet dhe pretendimet e tyre, as Bashkia Tiranë, Administratorja e njësisë administrative nr. 10 Tiranë, zj. Karolina Kostallari dhe as kandidatët për deputet zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Billako.



4. Referuar ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, palët kanë disa të drejta procedurale për të marrë pjesë në hetimin administrativ për të dhënë shpjegime për akuzat apo pretendimet e ngritura nga pala tjetër në kallëzimin e saj drejtuar KSHZ. Në këtë kontekst KAS konstaton se: si Administratorja e njësisë administrative nr.10, zj. Karolina Kostallari, ashtu edhe kandidatët për deputetë zj. Skëndo dhe z. Bllako, nuk janë trajtuar si palë procedurale, duke u shkelur parimi i një procesi ligjor të drejtë.

KSHZ ka vlerësuar se kandidatët për deputetë zj. Klediana Skëndo dhe z. Alqi Bllako nuk përfshihen në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, por nuk ka analizuar përgjegjësinë për shkelje eventuale të detyrimeve specifike të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Për këtë arsye, kandidatët për deputetë duhet gjithashtu të thirren në procedim dhe t’i garantohen të drejtat sipas Kodit të Procedurave Administrative.

5. Neni 81, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative përcakton se “organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji”. Në rastin konkret rezulton se KSHZ është mjaftuar vetëm me shkëmbimin e korrespondencës me Bashkinë e Tiranës, administratoren e njësisë administrative nr.10 zj. Karolina Kostallari, pa hetuar më shumë për të mbledhur prova dhe fakte që do të vërtetonin shkeljen ose jo të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. KAS për këtë arsye konstaton se hetimi i kryer nga ana e KSHZ nuk është i plotë dhe i gjithanshëm, pasi nuk janë shteruar të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore për të siguruar provat dhe faktet e nevojshme për çështjen.

6. Referuar nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, *pas përfundimit të procedurës hetimore, (...) palët e interesuara kanë të drejtë të shprehen përpara marrjes së vendimit përfundimtar*. Si palë e interesuar në procedimin administrativ ka të drejtë të marrë pjesë çdokush që ka interes të ligjshëm, bazuar në nenin 44, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative. KAS çmon se subjekti ankues, Organizata “Qëndresa Qytetare” shfaq një interes të ligjshëm në këtë procedim duke qenë dhe kallëzuesi i denoncimit dhe për këtë arsye duhet thirrur si palë e interesuar në procedimin administrativ të ndjekur nga KSHZ.

7. KAS çmon se respektimi i të drejtave dhe garancive procedurale të palëve pjesëmarrëse në procesin administrativ, ka rëndësi vendimtare për respektimin e procesit të rregullt ligjor. Për këto arsye KAS, i cili në këtë fazë të procesit nuk ka marrë në analizë ligjshmërinë e argumenteve të KSHZ përsa i përket themelit të çështjes, vlerëson që ky i fundit duhet t’u japë mundësinë palëve të njihen dhe të përballen me to.

PËR KËTO ARSYE

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i

V E N D O S I

1. Shfuqizimi e vendimit nr. 424, datë 12.07.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Tiranë, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.
2. Riçeljen e hetimit administrative të plotë dhe të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke u garantuar të drejtat palëve në procesin administrative, subjekteve të kallëzuara në denoncimin në fjalë (kandidatëve për deputetë, subjektit zgjedhor përkatës dhe bashkisë Tiranë).
3. Të thirret në këtë proces si palë e interesuar kallëzuesi Organizata “Qëndresa qytetare”.
4. Në përfundim të hetimit, bazuar në germën “dh” të pikës 1, të nenit 21, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në rast se evidenton kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, t’i propozojë KAS vendosjen e sanksioneve përkatëse kundrejt personave përgjegjës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis **ÇEFA** - **Kryesues**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**

